

MARRËVESHJE MBI KREDINË KONSUMUESE

NENI 1 - QËLLIMI I MARRËVESHJES

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është financimi i Huamarrësit, në formë të kredisë, nga ana e Huadhënësit, në përputhje me afatet dhe kushtet e specifikuar në këtë marrëveshje..

2. Kredia është lëshuar me qëllim konsumues për Huamarrësin, dhe nuk mund të përdoret për asnjë qëllim tjetër nga ana e Huamarrësit

NENI 2 - KUSHTET DHE AFATET E LEJIMIT TË KREDISË

1. Huadhënësi dhe Huamarrësi janë pajtuar që, kredia e lejuar nga Huadhënësi, t'i nënshtrohet kushteve dhe afateve, si në vijim:

1.1. Shuma e lejuar e kredisë: 100 euro, 300 euro, 500 euro

1.2. Norma e interesit: 2% (mujore) 24% (vjetore)

1.3. Norma efektive e interesit: 26.82%

1.4. Tarifa administrative: 0%

1.5. Kohëzgjatja e huasë: 1 muaj, 2 muaj, 3 muaj;

1.6. Qëllimi i kredisë: Kredi për pagesa

NENI 3 - APLIKIMI DHE LLOGARITJA E INTERESIT

1. Përveç borxhit kryesor/kryegjësë, Huamarrësi po ashtu ka për detyrim edhe interesin e kontraktuar me këtë marrëveshje, me kushtet si në vijim:

1.1. Përqindja e normës së interesit është specifikuar në pikën b), të paragrafit 2.1, të nenit 2, të kësaj marrëveshje;

1.2. Numri aktual i ditëve (kalendarike) të muajit dhe vitit me 365/366 ditë do të përdoret për llogaritjen e normës së interesit.

1.3. Norma e interesit do të mbetet fikse gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kredisë, me përjashtim të rasteve që përfshijnë ristrukturimin e kredisë për arsye të vonesave në pagesë, ndryshimit të interesit preferencial nga ana e Huamarrësit, apo në rastet e refinancimit me normë dhe maturitetit tjetër, sipas marrëveshjes në mes të Huamarrësit dhe Huadhënësit.

1.4. Shuma totale e kredisë dhe kësti mujor, janë paraqitur në Planin e Pagesave, i cili konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje. Sidoqoftë, pavarësisht kësaj, Huadhënësi mund të ndodh të paguajë më tepër se shuma totale për pagesë në rast se nuk e paguan kredinë me rregull, me ç'rast do të aplikohet kamatëvonesa dhe shpenzimet tjera eventuale për shkak të mospërmbushjes së obligimeve nga kjo kredi.

2. Norma Efektive e Interesit nënkupton koston totale të kredisë, të paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë, përmes së cilës hyrjet e diskontuara të parasë së gatshme duhet të barazohen me daljet e diskontuara të parasë së gatshme. Për diskontim duhet të përdoret numri aktual i ditëve (kalendarike) të muajit dhe viti me 365/366 ditë. Në normën efektive të interesit nuk janë përfshirë shpenzimet e shënuara në Nenin 11, të kësaj marrëveshje.

3. Huadhënësi dhe Huamarrësi pajtohen që, përveç interesit të specifikuar më lartë, në rast se Huamarrësi nuk i përmbush obligimet e tij në përputhje me Planin e Pagesave, Huamarrësi do të ketë për detyrim edhe kamatëvonesën e kontraktuar me këtë marrëveshje, me kushtet si në vijim.

3.1. Përqindja e kamatëvonesës është 1% në muaj (12% në vit) dhe do të llogaritet mbi shumën e kryegjësë së pa paguar të secilit këst në vonesë.

3.2. Kamatëvonesa do të fillojë të aplikohet pas ditës së 5-të (pestë), të secilit këst në vonesë dhe do të llogaritet nga dita e parë vonesës e deri në ditën e pagesës së plotë të secilit këst në vonesë;

3.3. Huamarrësi është në dijeni se kamatëvonesa e kontraktuar në këtë paragraf është në përputhje të plotë me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, prandaj pajtohet dhe deklaron se heq dorë nga çfarëdo kundërshtimi lidhur me aplikimin e kamatëvonesës, si dhe përqindjes së kamatëvonesës të specifikuar në pikën a), të këtij paragrafi, duke e autorizuar Huadhënësin që të aplikojë kamatëvonesën për secilin këst që nuk paguhet në përputhje me Planin e Pagesave.

NENI 4 - MËNYRA E PAGESËS SË KREDISË

1. Huamarrësi duhet të paguajë kredinë, duke përfshirë kryegjënë dhe interesin, në përputhje me datat e pagesave, të specifikuara në Planin e Pagesave, i cili është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje

2. Pagesa mund të bëhet përmes deponimit të parave të gatshme, apo përmes transferit bankar të të hollave në llogarinë e Huamarrësit të përcaktuar për pagesë të kredisë, të hapur tek Huadhënësi

3. Pagesa e secilit këst të kredisë nuk konsiderohet se është kryer vetëm nga fakti se mjetet për pagesë të këstit të kredisë janë deponuar, apo transferuar në llogari. Pagesa konsiderohet e kryer vetëm atëherë kur Huadhënësi e ka të mundur që t'i tërheqë mjetet për pagesë të këstit të arritur për pagesë.

NENI 5 - PARAPAGIMI I KREDISË

1. Klienti ka të drejtë në çdo kohë përpara datës së maturimit të shlyejë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e tij nga marrëveshja e kredisë konsumatore. Në këtë rast, kreditori duhet të bëjë një ulje të koston totale të kredisë. Ky reduktim konsiston në uljen e interesit dhe kostove të aplikuara për pjesën e papaguar të kredisë, për periudhën e mbetur sipas kredisë së marrëveshjes. Pas pranimit të kërkesës për parapagim të kredisë, huadhënësi duhet të kryejë të gjitha procedurat e mbylljes së kredisë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

2. Në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit, huadhënësi ka të drejtën e kompensimit të kostove të drejta dhe të arsyeshme që lidhen drejtpërdrejt me shlyerjen e kredisë para afatit, me kusht që shlyerja e parakohshme t'i përkasë periudhës gjatë së cilës norma e interesit. është fikse, siç përcaktohet në marrëveshjen e huasë.

3. Nëse periudha ndërmjet shlyerjes së parakohshme dhe maturimit të kredisë është mbi një (1) vit, kompensimi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni nuk kalon një (1%) për qind të shumës së kredisë së paguar para afatit dhe nëse kjo periudhë nuk kalon një (1) vit, kompensimi nuk do të kalojë zero pikën pesë (0.5%) për qind të shumës së kredisë - principali i paguar para afatit.

4. Kompensimi për pagesën para afatit të maturimit nuk do të kërkohet:

4.1. nëse shlyerja realizohet në bazë të një kontrate sigurimi, e cila ka si qëllim shlyerjen e kredisë;

4.2. në rastin e kredisë në formën e mbitërheqjes; OSE

4.3. nëse shlyerja e kredisë para afatit i përket një periudhe për të cilën norma e kredisë nuk është fikse.

5. Çdo kompensim nuk duhet të kalojë shumën e interesit që konsumatori do të kishte paguar përgjatë periudhës mes pagesës së parakohshme dhe datës së caktuar të përfundimit të marrëveshjes së kredisë.

6. Huamarrësi pajtohet dhe deklaron se nuk do të kontestojë në asnjë mënyrë aplikimin e tarifës së ndëshkimit përshkruar më lartë, duke hequr dorë nga çfarëdo ankese apo pretendimi lidhur me tarifën e ndëshkimit për parapagim.

NENI 6 - PËRFAQËSIMI DHE GARANCITË

1. Huamarrësi deklaron dhe garanton se:

1.1. Ka të gjitha autorizimet e nevojshme për të hyrë në këtë marrëveshje dhe për të realizuar dhe përmbushur secilin prej afateve dhe kushteve të parapara në këtë marrëveshje;

1.2. Të gjitha informacionet e deklaruara në kërkesën për kredi, në këtë marrëveshje dhe në çdo dokument tjetër në lidhje me këtë marrëveshje, janë të sakta, të plota, të përditësuara dhe të njëjtat përfaqësojnë në mënyrë të drejtë situatën reale të Huamarrësit;

1.3. Të gjitha informatat financiare të deklaruara nga Huamarrësi janë të sakta, të vërteta dhe të njëjtat pasqyrojnë gjendjen reale financiare të Huamarrësit.

1.4. Të gjitha të ardhurat financiare rrjedhin nga aktiviteti i ligjshëm dhe në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Kosovës;

1.5. Të gjitha obligimet financiare ndaj palëve të treta përmes kredive, apo përmes çfarëdo forme tjetër të financimit, janë paraqitur në mënyrë të saktë dhe të drejtë;

1.6. Të gjitha fondet e lejuara nga Huadhënësi, përmes kësaj marrëveshje, do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë lejuar dhe për asnjë qëllim tjetër;

1.7. Nuk është nën hetime nga asnjë autoritet;

1.8. Hyrja në këtë marrëveshje dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje, nuk do të rezultojë në shkelje nga ana Huamarrësit të çfarëdo marrëveshje tjetër, në të cilën Huamarrësi është palë ose nga të cilat marrëveshje është i obliguar.

NENI 7 - OBLIGIMET E HUAMARRËSIT

1. Obligimet e cekura në vijim janë obligime të përgjithshme dhe shkelja e tyre përbën rast të mospërmbushjes së kredisë. Huamarrësi obligohet që:

1.1. Të paguajë kredinë me kohë dhe pa asnjë vonesë, në përputhje me Planin e Pagesave;

1.2. Të sigurojë një faturë të pagesës për shfrytëzimin e kredisë.

1.3. Të shfrytëzoj fondet e kredisë vetëm për qëllimin e caktuar në këtë marrëveshje;

1.4. Të informojë menjëherë Huadhënësin në rast se paraqiten rrethana të cilat mund të ndikojnë negativisht në mundësinë e tij/saj për të paguar kredinë në mënyrë të rregullt;

1.5. Të mos hyjë në asnjë marrëveshje kreditore me asnjë institucion tjetër, e cila mund të zvogëlojë kapacitetin e tij/saj financiar deri në atë masë sa të rrezikojë pagesën me kohë të kësaj kredie.

1.6. Çdo obligim tjetër që del nga kjo marrëveshje, apo ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

2. Asnjëra nga pikat e lartpërmendura nuk e liron Huamarrësin nga të gjitha obligimet tjera të parapara me këtë marrëveshje dhe ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Kosovës. .

h4>NENI 8 - RASTET E MOSPËRMBUSHJES SË KREDISË

1. Rastet e mëposhtme konsiderohen raste të mospërmbushjes së marrëveshjes dhe paraqitja e cilit do prej tyre i jep të drejtë Huadhënësit që të realizoj të drejtat e tij, të kësaj marrëveshje:

1.1. Dështimi nga ana e Huamarrësit që të paguajë me rregull këstet e kredisë, në përputhje me Planin e Pagesave

1.2. Shfrytëzimi i fondeve të kredisë në kundërshtim me qëllimin për të cilin janë lejuar, përmes kësaj marrëveshje;

1.3. Sigurimi i informacionit mashtrues ose i falsifikuar, ose fshehja e informacionit të rëndësishëm, që mund të ndikojë në vendimin e Huadhënësit për të lejuar këtë kredi, ose që mund të ndikojë në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje;

1.4. Dhënia e informatave çorientues apo të falsifikuara, apo fshehja e informatave të rëndësishme, që kanë mundur të ndikojnë në vendimin e Huadhënësit për të lejuar këtë kredi, apo që mund të ndikojnë në kapacitetin e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje;

2. Asnjëra nga pikat e lartpërmendura nuk i kufizon përgjegjësitë e Huamarrësit që dalin nga të gjitha nenet tjera të kësaj marrëveshje, dhe asnjëra nga pikat e lartpërmendura nuk e kufizon të drejtën e Huadhënësit që të ndërmerr ndonjëren nga veprimet e në këtë marrëveshje, nëse Huamarrësit dështojnë në përmbushjen e cilitdo nga kushtet tjera të parapara në këtë marrëveshje, apo ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

NENI 9 - TË DREJTAT DHE KOMPENSIMET E HUADHËNËSIT

1. Në rast se Huamarrësi dështon në përmbushjen e cilit do prej kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshje, Huadhënësi ka këto të drejta dhe kompensime, që do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në:

1.1. Kërkesën drejtuar Huamarrësit që menjëherë të bëjë pagesën e kësteve në vonesë, duke përfshirë të gjitha shpenzimet e shkaktuara për shkak të vonesës në pagesë, si dhe të interesat e llogaritura deri në datën e pagesës;

1.2. Kërkesën drejtuar Huamarrësit që menjëherë të bëjnë pagesën e shumës totale të kredisë, duke përfshirë të gjitha interesat dhe shpenzimet e llogaritura deri në datën e pagesës;

1.3. Bllokimin e të gjitha llogarive të Huamarrësit të hapura tek Huadhënësi dhe tërheqjen e të gjitha mjeteve që ndodhen në këto llogari me qëllim të pagesës së borxhit të Huamarrësit;

1.4. Të kërkohet nga punëdhënësi i Huamarrësit që të transferojë tek llogaria e Huamarrësit, e hapur tek Huadhënësi, të gjitha të ardhurat e tij/saj në emër të pagës, apo kompensimeve tjera nga marrëdhënia e punës;

1.5. Ndryshimin e interesit preferencial, sipas kushteve të kësaj Marrëveshje;

1.6. Ndërmarrja e të gjitha veprimeve ligjore ndaj Huamarrësit

1.7. Shkëputjen e marrëveshjes në tërësi;

1.8. Nëse kredia është bazuar në informata çorientuese apo të falsifikuara, Huadhënësi mund ta deklarojë marrëveshjen kreditore si të shkelur në momentin e zbulimit të informatave të tilla, sipas ligjit të aplikueshëm;

2. Huadhënësi ka të drejtë që në mënyrë të njëanshme dhe pa asnjë paralajmërim për Huamarrësin, të bëjë anulimin e të gjitha fondeve të pashfrytezuara nga ana e Huamarrësit dhe gjithashtu të kërkojë që të kthehen menjëherë të gjitha fondet e shfrytëzuara të kredisë, në rast se Huamarrësi përdor ndonjë pjesë të fondeve të kredisë për qëllime të tjera nga qëllimi për të cilin është lejuar kredia, dhe ta deklarojë marrëveshjen e kredisë si të shkelur nga ana e Huamarrësit, sipas ligjit të aplikueshëm.

3. Asnjëra nga pikat e lartpërmendura nuk e kufizon të drejtën e Huadhënësit që të ndërmerr masa tjera ndaj Huamarrësit në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

NENI 10 - KOSTOJA E KREDISË

1. Huamarrësi pajtohet dhe është në dijeni se ekzekutimi i kësaj marrëveshje mund të ketë edhe shpenzime të cilat të cilat mund të aplikohen qoftë nga Huadhënësi, qoftë nga institucione të ndryshme, dhe si të tilla nuk janë të përfshira në koston e përgjithme të kredisë, apo në Normën Efektive të Interesit - NEI. Huadhënësi është në dijeni se këto shpenzime nuk janë të përfshira në normën efektive të interesit, dhe deklaron se të njëjtat i pranon pa asnjë kundërshtim, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në:

1.1. Çdo shpenzim tjetër i kërkuar nga institucionet e tjera lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, gjatë gjithë kohës;

1.2. Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje.

2. Huamarrësi është i vetëdijshëm se shpenzimet e sipërpërmendura janë të detyrueshme dhe nuk përfshihen në normën efektive të interesit dhe deklaron se do t'i paguajë me fondet e veta dhe në mënyrën dhe kohën e kërkuar.

NENI 11 - MBLEDHJA, RAPORTIMI DHE KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE

1. Huadhënësi, gjatë procesit të kreditimit, e ka të nevojshme të mbledhë informata mbi historikun e kredive të Huamarrësit drejtpërdrejtë përmes këtyre të fundit, apo përmes institucioneve kompetente të autorizuara për të ndarë informata mbi Huamarrësin. Prandaj, përmes këtij paragrafi, Huamarrësi i jep pëlqim Huadhënësit që të kërkojë informata nga Regjistri i Kredive të Kosovës dhe nga çfarëdo institucioni tjetër kompetent për dhënien e këtyre informatave.

2. Huadhënësi, gjatë procesit të kreditimit, duhet të ofrojë informata mbi historikun e kredive të Huamarrësit, tek institucionet kompetente të autorizuara për të mbledhur këto informata. Prandaj, përmes këtij paragrafi, Huamarrësi jep pëlqim Huadhënësit që t'i ofrojë informata Regjistrin të Kredive të Kosovës dhe çfarëdo institucioni tjetër kompetent për mbledhjen e këtyre informatave.

3. Informatat e mbledhura nga Huamarrësi sipas më këtij neni, do të konsiderohen si informata konfidenciale dhe mund të shfrytëzohen vetëm për qëllim të financimit, mirëmbatjes/servisimit të kredisë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë.

4. Pavarësisht paragrafëve të lartpërmendur, Huamarrësi pajtohet dhe me këtë e autorizojnë Huadhënësin që, të gjitha informatat e mbledhura gjatë procesit të kreditimit, varësisht prej nevojës dhe vetëm deri në masën e domosdoshme për zbulim, mund t'i ndajë me kontraktorët e tij të jashtëm, siç janë: këshilltarët e jashtëm ligjor, këshilltarët financiar dhe/apo tatimor, auditorët e jashtëm, kompanitë për mbledhje të borxheve të këqija, avokatët, si dhe me çfarëdo kontraktori tjetër të jashtëm, vetëm nëse një zbulim i tillë është i domosdoshëm, deri në masën domosdoshme për zbulim dhe me kusht që marrësi i këtyre informatave gjithashtu të obligohet për konfidencialitet, përmes marrëveshjes me shkrim.

5. Asnjë nga obligimet për konfidencialitet, sipas këtij neni, nuk vlejnë nëse zbulimi i informatave kërkohet sipas ligjit, apo me kërkesë të organeve kompetente për zbulim të këtyre informatave.

NENI 12 - TRANSFERIMI I MARRËVESHJES

1. Në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye qoftë, Huadhënësi ka të drejtë në mënyrë të njëanshme të transferoj të drejtat e veta sipas kësaj marrëveshje tek një palë të tretë, e cila me anë të kësaj pranon edhe përgjegjësitë e Huadhënësit. Çdo transfer i të drejtave të Huadhënësit nga kjo marrëveshje nuk kërkon aprovimin e Huamarrësit.

2. Huamarrësi nuk mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo marrëveshje te një palë e tretë.

NENI 13 - E DREJTA PËR TËRHEQJE NGA MARRËVESHJA

1. Huamarrësi ka të drejtë të tërhiqet nga kjo marrëveshje e kredisë konsumuese, brenda një periudhe kalendarike katërmbëdhjetë (14) ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kontratës.

2. Përpara ushtrimit të kësaj të drejte Huamarrësi njofton Huadhënësin për synimin e tij (brenda afatit të lartcekur prej katërmbëdhjetë (14) ditëve për t'u tërhequr nga marrëveshja e kredisë.

3. Në qoftë se kredia është disbursuar dhe përfituar nga Huadhënësi dhe në qoftë se ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga marrëveshja, Huadhënësi njofton Huamarrësin për shumën e kredisë që duhet t'i rikthehet nga Huamarrësi. Kjo vlerë përbëhet nga shuma e kryegjësë dhe interesit për ditët përkatëse, si dhe shpenzimet e huadhënësit, duke përfshirë edhe ato shpenzime të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj kredie.

NENI 14 - NDËRFAQJA DHE PËRFUNDIMI I PAROHET I MARRËVESHJES

1. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje është specifikuar në pikën e), të paragrafit 2.1, të nenit 2, të kësaj marrëveshje, dhe nuk mund të ndryshojë, përveç nëse Huamarrësi dhe Huadhënësi pajtohen me shkrim për një gjë të tillë, apo në rastet tjera të parapara në këtë marrëveshje.

2. Pavarësisht asaj që është shënuar në paragrafin e mësipërm, në cilindo rast kur Huamarrësi shkel ndonjërin nga obligimet që dalin nga kjo marrëveshje, Huadhënësi ka të drejtë të deklarojë shuarjen e kësaj marrëveshje dhe të këkojë përmbushjen e tërësishme të kredise, duke përfshirë të gjitha interesat dhe shpenzimet e shkaktuara deri në pagesën e plotë të borxhit.

NENI 15 - LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E KONTESTEVE

1. Palët kontraktuese kanë pajtohen që kjo marrëveshje t'i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin në mes të palëve lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshje, së pari do të tentohet të zgjidhen me mirëkuptim. Nëse mosmarrëveshjet nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, atëherë palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës. Huadhënësi mund t'i drejtohet edhe organeve tjera kompetente, siç janë Përmbaruesit Privatë, me qëllim të realizimit të të drejtave të veta, lidhur me këtë marrëveshje.

NENI 16 - NDRYSHIMI I MARRËVESHJES DHE SHTOJCAT

Çdo ndryshim i kushteve dhe afateve të kësaj marrëveshje duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga të gjitha palët që e kanë nënshkruar këtë marrëveshje, përmes shtojcave të marrëveshjes, të cilat do të konsiderohen pjesë përbërëse të kësaj marrëveshje.

NENI 17 - KOMUNIKIMI DHE NJOFTIMET

1. Huamarrësi pajtohet dhe pranon se, çdo komunikim dhe/apo njoftim që duhet të bëhet nga Huadhënësi për Huamarrësin duhet të bëhet përmes njëres nga/apo kombinimit të këtyre mënyrave në vijim:

1.1. Letrës postare;

1.2. Telefonatave;

1.3. SMS;

1.4. Postës elektronike (email);

1.5. Dorëzimit personal.

2. Huamarrësi pajtohet dhe deklaron se Huadhënësi ka lirinë e plotë për të vendosur se cilën nga mënyrat e lartpërmendura të komunikimit do të përdor për komunikime dhe njoftime me Huamarrësin dhe se nuk do të kundërshtojnë, në çfarëdo forme, asnjërën nga mënyrat e komunikimit dhe njoftimit, të zgjedhura nga Huadhënësi.

3. Huamarrësi pajtohet dhe deklaron se, secila nga mënyrat e komunikimit të specifikuara më lart në rastet kur dorëzohet ndonjë shkresë sipas marrëveshjes, konsiderohet dhe janë të barazvlefshme me komunikime dhe njoftime me shkrim, prandaj të njëjtat do të konsiderohen si prova me shkrim, në rast nevojë.

4. Huamarrësi pajtohet dhe deklaron se do të njoftojnë menjëherë Huadhënësin, për çfarëdo ndryshimi të adresës postare, numrit të telefonit, apo postës elektronike (e-mail), të deklaruara në aplikacionin për kredi dhe/apo në këtë marrëveshje. Në të kundërtën, pajtohen dhe deklarojnë se nuk do të mbajnë përgjegjësinë Huadhënësin për çfarëdo komunikimi apo njoftimi në këto adresa/numra të telefonit, dhe po ashtu heqin dorë nga çfarëdo ankese apo pretendimi ndaj Huadhënësit, për çfarëdo dëmi apo humbje që mund të pësojnë për shkak të vazhdimit të dërgimit të komunikimeve dhe njoftimeve në këto adresa/numra të telefonit, nga ana e Huadhënësit, si pasojë e mos-informimit nga ana e tyre për këto ndryshime.

5. Huamarrësi pajtohet dhe pranon se çdo komunikim dhe/apo njoftim që duhet të bëhet nga Huamarrësi për Huadhënësin, duhet të bëhet përmes postës në adresën e shënuar në preambulën e kësaj marrëveshjeje, apo të paraqitet personalisht në degën përkatëse.

NENI 18 - PROCEDURA E ANKESËS

1. Huamarrësi është në dijeni se, përveç mënyrës së komunikimeve dhe njoftimeve për Huadhënësin, të cilat janë specifikuar sipas kësaj marrëveshjeje, për çfarëdo vërejtje apo ankese lidhur me këtë marrëveshjeje, mund t'i drejtohen Huadhënësit përmes: a) adresës Rruga Perandori Justinian nr.132, Pejton Prishtine 10000 Prishtinë, Njësija për Trajtimin e Ankesave; b) përmes numrave të tel. 038-607-607 dhe 049-456-021 si dhe c) email-it support@paysera-ks.com.

2. Nëse Huamarrësi, nuk është i kënaqur me përgjigjen e Huadhënësit, atëherë mund t'i drejtohen BQK-së, Gjykatës, apo ndonjë institucioni tjetër, për trajtimin e ankesave të tyre

NENI 19: GJUHA DHE NUMRI I KOPJEVE

1. Kjo Marrëveshje është përpiluar në gjuhën Shqipe, nga një kopje për secilën palë.

2. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Huamarrësi, konfirmon se e ka marrë dhe lexuar informatën parakontraktuale për kushtet dhe afatet e kësaj kredie, draftin e kësaj marrëveshjeje dhe deklarojnë se me të gjitha këto pajtohen, pa asnjë vërejtje.